

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 585 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 47, datë 20.05.2016

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale Arkeologjike "Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Adrian Anastasi (IA), udhëheqës Prof. Muzafer Korkuti,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim në kuadër të Shkollës Doktorale Arkeologjike "Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Adrian Anastasi (IA), udhëheqës Prof. Muzafer Korkuti, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kërkime në Kepin e RODONIT, Kepin e LAGJIT, Liqenin e OHRIT, Liqenin e PRESPËS.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë maj – dhjetor 2016.
3. Harta me koordinatat e reja, për propozimin për shpalljen në mbrojtje paraprake të zonave "Lin 3" dhe "Hudenisht1", të cilat përfaqësojnë vendbanime prehistorike me palafite, të depozitohet nga IA, pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO